



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 18.01.2018,  
e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Shefki Gashi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar, këshilltarët e Kuvendit: Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Nol Nushi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Drlon Pireva (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Yll Rugova (LVV), Genc Sherifi (LVV), Adrian Berisha (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Visare Gashi (LVV), Valbona Petrovci (LVV), Vala Peshku (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Milot Podvorica (LVV), Mimoza Sylejmani (LVV), Qëndrim Sahiti (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Sokol Havolli (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Suzan Kika (AAK), Sami Boroci (AKR-AA), Vesel Makolli shef i GP-së (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Agim Kuleta (LB), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

**Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi anëtari më i moshuar i Kuvendit të Komunës, z. Shefki Gashi. Ai e hapi diskutimin rreth rendit të ditës.**

**Kryesuesi i ftoi anëtarët e rinj që ta bëjnë betimin para Kuvendit. Ata ishin: Mimoza Sylejmani në vend të Nora Kelmendit, Qëndrim Sahiti në vend të Arben Vitisë dhe Milot Podvorica në vend të Genc Bashotës.**

U konstatua se njëzëri u miratua ky

## **R E N D I T E:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese;**
- 2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 4. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;**
- 5. Pyetje dhe përgjigje;**
- 6. Të ndryshme.**

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese.**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes inauguruese.

**Pika e dytë**

**Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth zhvillimit të procedurës për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

**U konstatua se njëzëri u formua komisioni vlerësues, në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e procedurës së votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.**

**Për anëtarë të Komisionit për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e procedurës së votimit, nga GP i VV-së u propozua Genc Sherifi, nga GP i LDK-së Mustafë Krasniqi, nga GP i PDK-së Migjen Shala, nga GP i AAK-së Valbona Ajeti dhe nga GP i AKR-AA-së Rifat Deri.**

**Pas formimit të komisionit, kryesuesi kërkoi nga subjektet e partive politike që t'i bëjnë propozimet e tyre për kryesues të Kuvendit.**

Leonora Shabani – Bajraktari bëri të ditur se në emër të koalicionit LVV, AKR-AA, AAK, LB dhe Nisma, për kryesues të Kuvendit propozojnë z. Agim Kuleta.

Halim Halimi tha se Grupi i këshilltarëve të LDK-së e propozon z. Shefki Gashi.

Shefki Gashi, kryesues, kërkoi nga komisioni që të fillojë procedurën e votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

Pas përfundimit të votimit, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se në votim morën pjesë 51 (pesëdhjetë e një) anëtarë të Kuvendit, prej tyre 46 (dyzet e gjashtë) vota të vlefshme dhe 5 (pesë) vota të pavlefshme.

Genc Sherifi në emër të komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, bëri kumtimin e rezultateve të votimit. U konstatua se për kandidatin Agim Kuleta votuan 27 (njëzet e shtatë) anëtarë të Kuvendit, ndërsa për kandidatin Shefki Gashi votuan 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës u zgjodh Agim Kuleta.

*Agim Kuleta, kryesuesi i Kuvendit, i falënderoi anëtarët e Kuvendit për besimin e dhënë.*

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Agim Kuleta, kryesues, propozoi një pauzë të shkurtër, që të bëhet një konsultim me përfaqësuesit e subjekteve politike për t'i bërë propozimet nga secili subjekt.

U konstatua se Agim Kuleta shkon ex officio, për shkak të pozitës së kryesuesit.

Nga subjektet politike u dhanë këto propozime:

- nga LVV caktohen Visare Gashi, Vala Peshku, Milot Podvorica dhe Genc Sherifi,
- nga LDK caktohen Halim Halimi, Agim Gashi dhe Jeta Rafuna,
- nga PDK caktohet Blerand Stavileci,
- nga AAK caktohet Fadil Gashi dhe
- nga AKR-AA caktohet Sami Boroci.

U konstatua se njëzëri u miratua Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i përhershëm.

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.**

**Leonora Shabani - Bajraktari, në emër të koalicionit, për anëtarë të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës propozoi:**

- për NP "Termokos", Nol Nushi (LVV) dhe Arbenita Murseli (AKR);
- për NP "Sport Marketing", Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Besnik Mujeci, (LVV);
- për NP "Pastrimi", Sokol Berisha (AAK) dhe Vjosa Hamiti (LVV);
- për NP "Hortikultura", Valbona Ajeti (AAK) dhe Leonora Bajraktari (LVV);
- për Ndërmarrjen Publike Banesore, Egzon Azemi (LVV) dhe Qëndrim Sahiti (LVV);
- për NP "Stacioni i Autobusëve", Mirsad Vitia (LVV) dhe Rifat Deri (AKR-AA);
- për NP "Trafiku Urban", Adrian Berisha (LVV) dhe Bukurie Canolli (LB);
- për NP "Prishtina Parking", Eman Rrahmani (LVV) dhe Drilon Pireva (LVV).

**Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, për anëtarë të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës, propozoi:**

- për NP "Termokos", Milazim Vitija;
- për Ndërmarrjen Publike Banesore, Sami Salihu;
- për NP "Pastrimi", Mustafë Krasniqi;
- për NP "Hortikultura", Fitnete Bejta;
- për NP "Trafik Urban", Shefki Gashi;
- për NP "Sport Marketing", Kushtrim Sopa;
- për NP "Stacioni i Autobusëve", Haki Dragusha;
- për NP "Prishtina Parking", Shefqet Osmani.

**Blerand Stavileci, në emër të GP të PDK-së, për anëtarë të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës propozoi:**

- për NP "Termokos", Migjen Shala;
- për Ndërmarrjen Publike Banesore, Florida Canolli;
- për NP "Trafiku Urban", Kumrije Shabani - Ramadani;
- për NP "Stacioni i Autobusëve", Leutrim Retkoceri.

**Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e koalicionit LVV, AAK, AKR - AA, LB dhe Nisma dhe konstatoi se më 30 ( tridhjetë ) vota për, u miratua Vendimi për caktimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.**

**Agim Gashi** u shpreh kundër mënyrës së votimit dhe kërkoi nga kryesuesi që të respektohen procedurat sipas udhëzimit të Zyrës ligjore.

**Fatos Dibra** theksoi se nuk është obligative që të bëhen veç e veç këto vendime të caktimit të aksionarëve. Edhe gjatë viteve të kaluara ka pasur precedent, kur janë votuar të gjithë përnjëherë.

**Sokol Havolli** tha se është mirë që Zyra ligjore të na tregojë se a ka procedurë që e rregullon këtë, sepse në bazë të precedentëve nuk rregullohen çështjet që i takojnë natyrës procedurale, por nëse ka procedurë për këtë, atëherë duhet të na njoftoj Zyra ligjore dhe të na tregojë procedurën se si duhet të shkohet në votim.

**Shpend Ahmeti, kryetar,** tha se gjatë përvojës katërvjeçare në këtë Kuvend komunal kështu i kemi votuar aksionarët, gjithmonë kanë shkuar në grup sa i përket procedurave, vendimet vijnë si propozime në Kuvendin komunal ose votohen ose nuk votohen.

Pra, në momentin që ky vendim nënshkruhet nga kryesuesi, ashtu ai i dërgohet Ministrisë dhe brenda 15 ditëve njoftohemi se a është e ligjshme apo është e kundërligjshme.

**Halim Halimi** propozoi që votimi të bëhet ndaras.

**Blerand Stavileci** shprehu mendimin se është më mirë të votohen një nga një, të dihen cilët janë aksionarët.

**Shefki Gashi** kërkoi sqarim nga Zyra ligjore lidhur me procedurën e votimit.

Kryesuesi edhe njëherë konstatoi se është miratuar Vendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike në Komunën e Prishtinës, sipas propozimit të dhënë nga koalicioni.

**Pika e pestë dhe e gjashtë  
Pyetje dhe përgjigje dhe  
Të ndryshme.**

**Uran Ismaili** kërkoi nga ekzekutivi që grupet parlamentare t'i kenë zyrat e veta në objektin e Komunës, me arsyetimin se këto subjekte politike janë të zgjedhura me votën e qytetarëve. Një hap i tillë është praktik dhe demokratik.

**Kryesuesi** tha se do ta diskutojmë këtë çështje me ekzekutivin dhe shpresoj se do ta gjejmë një zgjidhje sa më shpejtë që është e mundur.

**Agim Gashi** shtroi pyetje për ekzekutivin, duke thënë se në lagjen "Dardania", blloku i parë, hyrja nr. 4, ka probleme me kanalizimin, ku bodrumet e ndërtesës janë të mbushura me fekale. Ka shumë ditë që po kërkohet ndihmë nga Komuna dhe ekzekutivi nuk arrin ta sanojë gjendjen, gjendje kjo emergjente për banorët që jetojnë aty.

Ai kërkoi nga ekzekutivi ta evidentojë dhe të ndërhyj menjëherë, sepse ajo është situatë emergjente.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi nga ekzekutivi që të bëhen publike CV-të e aksionarëve të sapozgjedhur të ndërmarrjeve publike komunale, sepse edhe qytetarët duhet të shohin një transparencë më të madhe prej këtij Kuvendi, dhe pastaj të reflektojë kjo edhe tek drejtorët e këtyre ndërmarrjeve publike komunale, e jo si herën e kaluar, të vijnë drejtorë nga qytetet e tjera dhe të mundohen që t'i zgjidhin problemet e qytetarëve të Prishtinës.

Ai kërkoi nga kryesuesi që të respektohet Rregullorja për transparencë.

**Naime Osmani**, theksoi se në fshatin Besi, përgjatë rrugës "Fazli Osmani", në vitin 2016 është rregulluar një pjesë e kanalizimit dhe më pas është dëmtuar rruga. Banorët e asaj pjese nuk kanë qasje me automjetet te shtëpitë e tyre, andaj konsideroj se kjo gjendje është emergjente dhe duhet të rregullohet.

**Egzon Azemi** tha se Prishtina është kryeqytet dhe është qytet i të gjithëve, pa marrë parasysh prej cilës komunë mund të jenë. E rëndësishme është që secili, kushdo që donë dhe është profesionalisht i gatshëm, mund të kontribuojë për kryeqytetin tonë, dhe kjo nuk duhet të merret si diçka negative, por madje duhet vlerësuar.

E dimë të gjithë se Ndërmarrja Publike Banesore është funksionalizuar në mandatin e qeverisjes së LVV-së, ndërsa gjatë mandateve të kaluara e dimë të gjithë se si kanë shkuar punët aty.

**Eman Rrahmani** tha se ne jemi të zgjedhur prej popullit, andaj nuk është e arsyeshme të publikohen CV-të e aksionarëve të ndërmarrjeve publike komunale.

Tjetër çështje është që drejtorët e ndërmarrjeve publike caktohen me konkurs, nuk emërohen prej neve, edhe nuk është e mundshme të zgjidhet prej Prishtinës apo qytetit tjetër, aty duhet pranuar ai i cili e meriton vendin e punës e jo të qytetit të cilit është.

**Adrian Berisha** tha se me insistimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe, drejtorët e ndërmarrjeve publike do të zgjidhen me konkurs, në mënyrë sa më transparente.

**Shefki Gashi** kërkoi nga të pranishmit që punët të merren me seriozitet, të bëhen sa më transparente dhe të mos krijohen raporte jo të mira që në fillim.

Mimoza Sylejmani tha se edhe ne jemi të shqetësuar për gjendjen në lagjen "Dardania", blloku i parë, hyrja nr. 4, ku aty ka probleme me kanalizimin, andaj dhe kam kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që ta evitojë këtë problem, sepse bodrumet e ndërtesës janë të mbushura me fekalë.

Vlora Dumoshi tha se bodrumi i banesës në lagjen "Dardania", blloku i parë, hyrja nr. 4, është i mbushur me ujë dhe fekalë, e kjo është si pasojë e neglizhencës së organeve komunale, andaj kërkoj që kjo çështje të sanohet sa më shpejt.

Blerand Stavileci kërkoj që të punojnë së bashku dhe ta bëjnë një plan vjetor për punën e Kuvendit, dhe mundësisht të dakordohen që mbledhjet të mbahen në ditën e enjte. Njëherësh kërkoj që higjiena në tualetin e Komunës të jetë në nivelin e duhur.

Sokol Havolli theksoi se problemet të cilat u ngritën janë në interes të secilit prej nesh, por edhe në interes të ekzekutivit që të shkojë dhe ta adresojë atë problem, e të mos na përsëritet situata si në mandatin e kaluar, ku pati tragjedi, e pastaj të gjejmë arsytetime për ato çështje.

Drilon Pireva tha se Ligji për bashkëpronësi na tregon që banesat në bashkëpronësi tashmë janë të pronarëve privatë, që do të thotë se në pjesën ku është në bashkëpronësi të pronarëve privatë nuk mund të investohet paraja publike. Për këtë arsye është bërë një projekt nga Ndërmarrja Publike Banesore, në bashkëpunim me banorët, për mirëmbajtjen e hyrjeve banesore, projekt ky që është duke vazhduar shumë mirë.

Dren Kukaj, drejtori i Drejtorisë së Pronës, tha se është e qartë se në rastet e tilla Komuna nuk gëzon kompetencë për ndërhyrje në zgjidhjen e problemeve, por ai shprehu gatishmërinë që çështjen e këtij problemi ta adresoj aty ku duhet të zgjidhet.

Kryesuesi tërhoqi vërejtjen, duke thënë se sot e kemi seancën e parë të Kuvendit, ku ka pasur momente kur është diskutuar në atë mënyrë që është dashur edhe t'u ndërpritet diskutimi, por në mbledhjet e radhës do t'i përmbahem saktë Rregullores për punën e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Procesmbajtësja  
Luljeta Selimi



Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta

Faqe 7 nga 8